

---

# RREGULLORJA

## Rregullorja e Përfitimit të Asistencës Financiare

### Kjo rregullore zbatohet për pikat e mëposhtme të Corwell Health:

Beaumont Corporate Shared Services, Beaumont Dearborn, Beaumont Farmington Hills, Beaumont Grosse Pointe, Beaumont Medical Group, Beaumont Pharmacy Solutions, Beaumont Royal Oak, Beaumont Taylor, Beaumont Trenton, Beaumont Troy, Beaumont Wayne, Post Acute Care (Beaumont) Corewell Health, Big Rapids (Mecosta County Medical Center), Continuing Care, Corporate, Gerber Memorial (Newaygo County General Hospital Association), Ludington (Memorial Medical Center of West Michigan), Outpatient/Physician Practices, Pennock (Pennock Hospital), Reed City (Reed City Hospital Corporation), SH GR Hospitals (Spectrum Health Hospitals), SHMG, Spectrum Health Lakeland (Lakeland Community Hospital Watervliet; Lakeland Hospitals at Niles and St. Joseph Inc.), United/Kelsey (Spectrum Health United; Spectrum Health Kelsey Hospital), Zeeland (Zeeland Community Hospital)

**Zbatueshmëria e kufizuar në:** Nuk zbatohet

**Nr. i referencës:** 2983

**Nr. i versionit:** 10

**Data e hyrjes në fuqi:** 11/01/2022

**Fusha funksionale:** Financë, Cikli i të ardhurave

**Zona Fusha e departamentit:** Financë, Qasja e pacientit

---

**Njoftim për mosdiskriminim:** Rregullorja e Corwell Health dhe e të gjitha subjekteve në varësi parashikon ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor për të gjithë. Corwell Health nuk do të bëjë dallime mbi bazën e racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, shtetësisë, gjinisë, besimit fetar, moshës, aftësive të kufizuara, bindjeve politike, orientimit seksual dhe gjendjes martesore ose familjare. Vendimet për pranimin dhe shqyrtimin do të bazohen vetëm te nevojat shëndetësore të pacientit, si dhe te kapaciteti e aftësitë për të ofruar kujdesin dhe trajtimin mjekësor të nevojshëm. Pranimi dhe trajtimi nuk do të refuzohet mbi bazën e prejardhjes etnike, ngjyrës, gjinisë, seksit, racës, origjinës kombëtare, besimit fetar, aftësive të kufizuara, moshës, statusit të AIDS, statusit veteran ose ushtarak, burimit të pagesës për shërbimet apo mbi ndonjë bazë tjetër që ndalohet nga ligjet federale, shtetërore ose vendore. Pacientët do të trajtohen në mënyrë që është në përputhje me identitetin e tyre gjinor. Përveç kësaj, qendrat shëndetësore të miratuara nga Korpusi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (National Health Service Corps), "NHSC" dhe Programi i Ripagimit të Huasë Shtetërore të Miçiganit (Michigan State Loan Repayment Program), "MSLRP", nuk do të bëjnë dallime në ofrimin e shërbimeve te një individ (dhe nuk do ta bazojnë të drejtën për pranim në program) në bazë të aftësive të një personi për të paguar, pavarësisht nëse pagesat për ato shërbime do të kryhen nën Medicare, Medicaid ose CHIP; dhe nuk do të bëjnë dallime mbi bazën e racës, ngjyrës, seksit, origjinës kombëtare, aftësive të kufizuara, fesë, moshës, orientimit seksual ose identitetit gjinor të një personi. Shiko [Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit](#) (Legacy Beaumont Health), [Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit](#) (Legacy Spectrum Health Lakeland), ose [Të drejtat dhe përgjegjësitë e pacientit](#) (Legacy Spectrum Health West Michigan) për hollësi të mëtejshme.

Një politikë e programit për zbritje zbatohet vetëm për qendrat shëndetësore të miratuara të NHSC dhe MSLRP. Shiko [Shtojcën B](#).

Shiko [Shtojcën C](#) për njoftimin e plotë lidhur me mosdiskriminimin, si edhe për disponueshmërinë e asistencës gjuhësore.

---

Subjektet do t'i referohen dokumentacionit shoqëruar, të përfshirë në këtë dokument, sipas rastit. Printimet e këtij dokumenti mund të jenë të papërditësuara ndaj duhet të konsiderohen të pakontrolluara.

## 1. Qëllimi

Të përcaktohet procesi për të bërë një përlogaritje të arsyeshme se kush pranohet për të përfituar asistencë financiare nga Corwell Health. Të komunikojë disponueshmërinë e asistencës financiare për pacientët dhe për publikun dhe të sigurohet që në kërkesat për asistencë financiare të zbatohen të njëjtat direktiva, pavarësisht nga vendndodhja e Corwell Healthku ofrohet shërbimi për pacientin.

Kjo rregullore ka për qëllim të plotësojë kërkesat e Seksionit 501(r) të Ligjit për të Ardhurat e Brendshme (Internal Revenue Code) të vitit 1986, i ndryshuar, sipas të cilit në spitale zbatohen kërkesa të caktuara lidhur me asistencën financiare, kufizime në përcaktimin e shumave për t'u paguar dhe aktivitete të faturimit, si dhe mbledhjes së pagesave. Pacientët që nuk kanë mundësi të paguajnë për shërbimet e ofruara në Corwell Health mund të kërkojnë asistencë financiare dhe mund t'u jepet asistencë financiare, në përputhje me rregullat dhe kushtet e kësaj rregulloreje.

Qëllimi i kësaj rregulloreje përfshingjithashtu zbatimin e rregullave të caktuara për raportimin e shpenzimevetë Medicare.

## 2. Përgjegjësitë

Kjo Rregullore e Përfitimit të Asistencës Financiare nga Corwell Health ("Rregullorja") do të administrohet nga personeli i caktuar i Corwell Health, siç përcaktohet nga proceset dhe edukimi i departamenteve për përfitimin e asistencës financiare.

## 3. Përbajtja e rregullores

Corwell Health do të eliminojë përgjegjësinë financiare të pacientit për kujdes shëndetësor emergjent ose të nevojshëm në rastet kur pacienti/garantuesi konsiderohet si i përshtatshëm sipas udhëzimeve për vështirësi financiare, të përcaktuara në Seksionin 6.6 në vijim, dhe bashkëpunon me Corwell Health për administrimin e procesit të departamentit për të drejtën e përfitimit të asistencës financiare. Para se të hiqet dorë nga kërkesat për të paguar, duhet të përcaktohet në mirëbesim nevoja financiare.

## 4. Filozofia

Baza e trajtimit do të jetë kujdesi shëndetësor emergjent ose i nevojshëm dhe jo detyrimi financiar. Përcaktimi i shumës së asistencës financiare do të bëhet duke u bazuar në nevojën financiare të dëshmuar dhe do të jepet në bashkëpunim me pacientin/garantuesin kurdoherë që është në gjendje. Të gjithë pacientët/garantuesit që aplikojnë për asistencë financiare do t'i nënshtrohen të njëjtit proces për përfitimin e asistencës financiare, pavarësisht se kush është paguesi kryesor.

Kujdesi shëndetësor i nevojshëm u referohet shërbimeve që nevojiten për të identifikuar ose trajtuar një sëmundje apo dëmtim, i cili është diagnostikuar ose dyshohet në mënyrë të arsyeshme se është i nevojshëm nga ana mjekësore, duke marrë parasysh nivelin më të përshtatshëm të kujdesit shëndetësor. Në varësi të gjendjes shëndetësore të pacientit, ambienti më i përshtatshëm për ofrimin e kujdesit shëndetësor mund të jetë banesa, klinika e mjekut, një qendër për pacientë të jashtëm ose një qendër shëndetësore për trajtim afatgjatë, qendër rehabilitimi ose shtrat spitali. Që të konsiderohet i nevojshëm nga ana mjekësore, një shërbim duhet:

- të jetë i nevojshëm për të trajtuar një sëmundje ose dëmtim;
- të jetë në përputhje me diagnozën dhe trajtimin e sëmundjeve të pacientit;
- të jetë në përputhje me standardet e praktikës së mirë mjekësore;
- të mos jetë vetëm për komoditetin e pacientit ose të mjekut të pacientit; dhe
- të jetë në nivelin e kujdesit shëndetësor më të përshtatshëm për pacientin, siç përcaktohet nga gjendja shëndetësore e pacientit dhe jo nga situata financiare apo familjare e pacientit.

Kujdesi emergjent konsiderohet "i nevojshëm nga ana mjekësore".

## 5. Rregullorja për kujdesin shëndetësor emergjent

Corwell Health do të ofrojë pa dallim kujdes shëndetësor për problemet shëndetësore emergjente për individët, pavarësisht se cilat janë aftësitë e tyre për të paguar apo nëse pranohen ose jo për të përfituar asistencë financiare. Problemet shëndetësore emergjente mund të vijnë si pasojë e fillimit të papritur të një problemi shëndetësor me simptoma akute, të cilat në mungesë të kujdesit mjekësor të menjëhershëm, ka të ngjarë të vënë në rrezik të rëndë shëndetin e pacientit, të shkaktojnë mosfunksionim ose keqfunksionim të rëndë të një

organi ose të një pjese të trupit. Corwell Health nuk do të përfshihet në veprime që i shkurajojnë personat për të kërkuar kujdes mjekësor urgjent dhe në këto raste, kujdesi shëndetësor emergjent do të ofrohet pa u penguar nga kërkesat për mbledhjen e detyrimeve financiare ose kryerjen e pagesave për pagesat paraprake të shërbimeve para trajtimit, siç tregohet më tej në rregulloren e Ligjit për Trajtimin Mjekësor Emergjent dhe Punës Aktive ([Emergency Medical Treatment and Active Labor Act](#), EMTALA, (Legacy Beaumont Health) ose në Rregulloren e Gjendjes Mjekësore Emergjente / Trajtimit / Transferimit (LIGJI PËR TRAJTIMIN MJEKËSOR EMERGJENT DHE PUNËS AKTIVE – ([Emergency Medical Condition / Treatment / Transfer Policy](#) (EMERGENCY MEDICAL TREATMENT AND ACTIVE LABOR ACT - EMTALA) (Legacy Spectrum Health).

## 6. Rregullorja

### 6.1. Kërkesa për vendbanimin

Për t'iu përmbajtur qëllimit tonë për të përmirësuar shëndetin, për të nxitur shpirtin human dhe për të dhënë shpresë, Corwell Health do të kufizojë marrjen në shqyrtim të kërkesave për asistencë financiare vetëm tek aplikuesit që paraqesin vërtetim vendbanimi prej të paktën gjashtë muajsh në Shtetin e Miçiganit ose në një komunitet të përfshirë në vlerësimin e spitalit për nevojat shëndetësore të komunitetit si një "komunitet" të cilit i shërben. Mund të bëjnë përjashtim pacientët që kanë nevojë për kujdes shëndetësor emergjent ose ata që kërkojnë kujdes shëndetësor të nevojshëm që nuk ofrohet në një zonë shërbimi të një ofruesi shëndetësor tjetër.

### 6.2. Përmbledhje

- 6.2.1. Para se të kërkojë asistencë financiare, pacienti/garantuesi dhe Corwell Health do të ndjekin të gjitha format e arsyeshme të pagesave nga palë të treta, siç përcaktohet në Seksionin 6.3.
- 6.2.2. Politika e Corwell Health parashikon që të kërkojë zgjidhje për shlyerjen e pagesës për kujdesin shëndetësor jo-emergjent ose jo-të nevojshëm nga ana mjekësore, duke përfshirë ndër të tjera studimet eksperimentale/kërkimore, shërbimet kozmetike jo të detyrueshme dhe procedurat kirurgjikale bariatrike *para* shërbimit, ose kur paraqitet fillimisht një deklaratë, përveç nëse tashmë janë marrë masa të tjera të miratuara për pagesën. Corwell Health do të kërkojë gjithashtu zgjidhje për shlyerjen e pagesës për kujdesin shëndetësor jo-emergjent që nuk është i autorizuar ose që nuk mbulohet nga siguracioni.
- 6.2.3. Pacientët/garantuesit që njoftojnë se nuk janë në gjendje të paguajnë ose që janë identifikuar nga Corwell Health si persona që mund të mos jenë në gjendje të paguajnë, do të referohen te personeli i caktuar i Corwell Health për shqyrtim sipas rastit. Më pas, personeli i Corwell Health mund të vazhdojë me aplikimin për asistencë financiare për të përcaktuar nëse vërtet ekziston pamundësi për të paguar. Pacientit/garantuesit mund t'i kërkohet që të paraqesë një kërkesë për asistencë financiare. Mund të merret një raport krediti për të verifikuar informacionin e dhënë në aplikim, por ai nuk do të përdoret vetëm për të marrë një vendim për sa i përket të drejtës së përfitimit të asistencës financiare. Procesi për përfitimin e asistencës financiare mund të refuzohet plotësisht ose pjesërisht për pacientë/garantues të caktuar, të cilët supozohet se kanë të drejtë të përfitojnë asistencë financiare dhe më pas verifikohen, në përputhje me politikën dhe procedurat e Corwell Health. Gjatë procesit të kontrollit për pranimin e supozuar, Corwell Health mund të llogarisë të ardhurat familjare të një pacienti, duke përdorur një model përlogaritjeje të zhvilluar nga një palë e tretë, e cila përdor informacion të raportimit të kreditit, të dhëna të vetëraportuara, burime të të dhënave të marketingut dhe të ardhurat mesatare për të tjerët pranë adresës së raportuar nga pacienti. Shembuj të tjerë të pranueshmërisë së supozuar mund të përfshijnë persona që konsiderohen të pastrehë ose që kanë vdekur pa pronë të paluajtshme.
- 6.2.4. Nëse si pasojë e procesit të aplikimit nuk plotësohen kriteret për përfitim të asistencës financiare, pacienti/garantuesi do të këshillohet që të kryejë pagesën sipas [Rregullores për faturimin dhe marrjen e pagesave](#) (Legacy Beaumont Health) ose sipas [Rregullores për faturimin dhe marrjen e pagesave nga pacientët e përgjegjshëm](#) (Legacy Spectrum Health) dhe procedurave të zbatueshme, sipas së cilave një pacient/garantues mund të kualifikohet për zbritje dhe/ose alternativa të tjera pagese, si për shembull zbritje për pagesat e shpejta, plane pagesash, etj.
- 6.2.5. Nëse duket se mund të mos aplikohen direktivat për vështirësi financiare, pacientit/garantuesit mund t'i kërkohet që të paraqesë dokumentacion mbështetës, siç tregohet me hollësi në aplikim, dhe aplikimi do të përpunohet sipas rastit.
- 6.2.6. Llogaria e pacientit do të dokumentohet me rezultatet e vendimit. Do të bëhen përpjekje të arsyeshme për të informuar pacientin/garantuesin me shkrim për vendimin (duke përfshirë, nëse zbatohet, asistencën për të cilin personi pranohet) dhe bazën vendimin.

Subjektet do t'i referohen dokumentacionit shoqërues, të përfshirë në këtë dokument, sipas rastit  
Printimet e këtij dokumenti mund të jenë të papërditësuara ndaj duhet të konsiderohen të pakontrolluara.

**6.2.7.** I gjithë dokumentacioni i zbatueshëm dhe mbështetës për aplikimet do të ruhet në përputhje me [Rregulloren dhe procedurat për ruajtjen e dokumenteve](#) (Legacy Beaumont Health) ose me [Rregulloren për menaxhimin, ruajtjen dhe shkatërrimin e regjistrimeve](#) (Legacy Spectrum Health).

### **6.3. Burimet e pagesave të palëve të treta**

Para se të kërkojë asistencë financiare, pacienti/garantuesi dhe Corwell Health do të ndjekin të gjitha format e arsyeshme të pagesave nga palë të treta, duke përfshirë ndër të tjera Medicaid dhe regjistrimin në Health Insurance Marketplace.

Corwell Health ka të drejtë të hetojë, të verifikojë, të intervistojë dhe të kërkojë caktimin e:

- të gjitha përfitimeve nga cilido burim siguracioni i palëve të treta;
- të gjitha përfitimeve nga programet e asistencës shtetërore ose federale, për të cilët pacienti/garantuesi mund të pranohet;
- të gjitha përfitimeve nga cilado organizatë bamirësie; dhe/ose
- mosmarrëveshjeve në pritje.

Asistenca financiare është shpresa e fundit për zgjidhje. Si e tillë, pacienti/garantuesi duhet të përbushë të gjitha detyrimet që ka sipas cilitdo programi të zbatueshëm që përmendet më sipër, ose të përdorë burimet personale të disponueshme, përpara se të kualifikohet për asistencë financiare. Mosdhënia e informacionit të nevojshëm apo mospjesëmarrja në asnjë prej programeve të mësipërme mund të çojë në refuzim të kërkesës për asistencë financiare.

### **6.4. Disponueshmëria e asistencës financiare**

Corwell Health ka zbatuarmasa për publikimin e gjerë të komunikimeve në lidhje me disponueshmërinë e asistencës financiare të pacienti dhe publiku. Metodatat e komunikimit, ndër të tjera, përfshijnë tabelat në departamentin e urgjencës së spitalit, zonat e regjistrimit dhe vende të tjera publike, si edhe informacion rreth faqes së internetit të Corwell Health (siç tregohet në Seksionin 6.5). Përveç kësaj, Corwell Health do të japë në gjuhë të thjeshtë, një përmbledhje të rregullores së tij mbi të drejtën e përfitimit të asistencës financiare, si pjesë e procesit të shtrimit dhe/ose daljes së pacientëve, si edhe do t'u ofrojë personave ndihmë lidhur me kryerjen e procesit të aplikimit.

Pacientët do të njoftohen lidhur me Rregulloren për të drejtën e përfitimit të asistencës financiare për një periudhë prej të paktën 120 ditësh nga data e faturimit të parë pas daljes nga spitali. Bilancet e pacientit do të pranohen për vlerësim për asistencë financiare për të paktën 240 ditë nga data e faturës së parë pas daljes nga spitali ("Periudha e aplikimit"). Nëse Corwell Health merr një kërkesë për asistencë financiare gjatë periudhës së aplikimit, pavarësisht nëse aplikimi është i plotë apo jo, ai do të pezullojë çdo përpjekje për marrje të pagesës derisa të merret një vendim lidhur me të drejtën e përfitimit të asistencës financiare.

Disa shërbime mund t'u ofrohen pacientëve në Corwell Health nga ofrues që mund të mos përdorin rregulloren dhe procesin e Corwell Health për të drejtën e përfitimit të asistencës financiare. Për një listë të këtyre ofruesve, ju lutemi të shikoni versionin më të fundit të [Shtojcës A](#), e cila do të përditësohet rregullisht ndërsa informacioni ndryshon me kalimin e kohës.

### **6.5. Procesi i identifikimit dhe i aplikimit për asistencë financiare**

Qëllimi i procesit të shqyrtimit të së drejtës për të përfituar asistencë financiare ka për qëllim të përcaktojë nëse pacienti/garantuesi është në gjendje të paguajë.

Një kopje falas e rregullores së të drejtës për të përfituar asistencë financiare, si edhe [aplikimi](#) aktual për asistencë financiare dhe një përmbledhje në gjuhë të thjeshtë e rregullores mund të gjenden në të gjitha pikat e Corwell Health. Gjithashtu mund të merret një kopje falas si vijon:

- Për Legacy Beaumont Health:

- <https://www.beaumont.org/patients-families/billing/financial-assistance>
- duke telefonuar (248) 577-9205
- ose duke dërguar email në [patient\\_financial\\_resources@beaumont.org](mailto:patient_financial_resources@beaumont.org)
- Për Legacy Spectrum Health Lakeland:
  - <https://www.spectrumhealthlakeland.org/patient-visitor-guide/patient/billing/financial-assistance>
  - duke telefonuar (844) 408.4103
  - ose duke dërguar email në [SHLfinancialcounseling@spectrumhealth.org](mailto:SHLfinancialcounseling@spectrumhealth.org)
- Për Legacy Spectrum Health West Michigan:
  - <https://www.spectrumhealth.org/affording-care/financial-assistance>
  - duke telefonuar (800) 968.0145
  - ose duke dërguar email në [FinancialCounseling@spectrumhealth.org](mailto:FinancialCounseling@spectrumhealth.org)

Çdo personi mund t'i kërkohet të plotësojë një aplikim për asistencë financiare dhe të japë informacionin e kërkuar nga Corwell Healthsi pjesë e aplikimit. Corwell Health përcakton asistencën financiare, duke u bazuar në direktivat për vështirësitë financiare të përcaktuara në Seksionin 6.6. Corwell Health mund të kërkojë kopje të mandatpagesave, të tatimit mbi të ardhurat federale dhe çdo burim tjetër për verifikimin e të ardhurave dhe pasurive që tregohen në aplikim. Mund të përdoren teknologjia dhe regjistrime të tjera publike, si dosjet për falimentim, regjistrimet e vdekjeve dhe dosjet për pronat e paluajtshme për të ndihmuar në dallimin në mënyrë proaktive dhe të efektshme të pacientëve që kualifikohen për asistencë, kur nuk janë në gjendje të japin informacion të plotë të aplikimit, ose të automatizohet procesi i marrjes së të dhënave të nevojshme dhe i analizës lidhur me aftësinë për të paguar në rrethana të veçanta. Kur përdoret teknologjia për të ndihmuar me të drejtën e supozuar të përfitimit, ajo do të përdoret për të marrë informacionin e kërkuar si pjesë e aplikimit. Pranueshmëria e supozuar do t'u jepet aplikuesve që kanë mbrojtje të konfirmuar ndaj falimentimit, që kanë vdekur pa pronë të paluajtshme, që janë të pastrehë, siç shprehet në regjistrimet e qendrave të strehimit ose nga burime të tjera të pranuar. Aplikuesve mund t'u kërkohet të ndihmojnë dhe të bashkëpunojnë në aplikimin për përfitime nga siguracione të palëve të treta, programe shtetërore, programe federale apo programe të tjera bamirësie, të cilat janë përmendur te Seksioni 6.3 më sipër.

Një pacient që është përfitues i Medicaid do të konsiderohet se kualifikohet për asistencë financiare 100% në formën e një rregullimi për kujdes shëndetësor bamirësie.

Corwell Health mund të delegojë vendimin për të drejtën e përfitimit të asistencës financiare tek organizata partnere në përpjekje për të shmangur punën e dyfishtë. Organizatat partnere do të miratojnë direktivat e kësaj rregulloreje për qëllime kualifikimi, ose sipas natyrës së popullatës të cilës u shërbejnë, do të plotësojnë kërkesat minimale të aplikimit tonë. Kur ndodh delegimi, Corwell Health do të rishikojë rregullisht dokumentacionin e organizatave që bëjnë përcaktimin për t'u siguruar për pajtueshmërinë me këtë rregullore.

#### **6.6. Kualifikimet e direktivave për vështirësi financiare**

Përveç pacientëve që marrin kujdes shëndetësor në një qendër të miratuar nga Korpusi i Shërbimit Shëndetësor Kombëtar (National Health Service Corps), "NHSC", ose në një qendër të miratuar nga Programi i Ripagimit të Huasë Shtetërore të Miçiganit (Michigan State Loan Repayment Program), "MSLRP", në përcaktimin e pranueshmërisë për asistencë financiare, Corwell Health do të vlerësojë aftësinë e pacientit/garantuesit për të rimbursuar Corwell Health për shërbimet që po kërkohen ose që janë ofruar më parë.

Corwell Health do të vlerësojë informacione të tilla si, këto të mëposhtmet, kur bën vlerësimin e aftësisë për të paguar:

- Nivelet e të ardhurave
- Vlera neto
- Statusi i punësimit
- Detyrime të tjera financiare
- Sasia dhe shpeshtësia e faturave të kujdesit shëndetësor

Mund të merret një raport krediti për të verifikuar informacionin e mësipërm. Corwell Health do të përdorë direktivat federale amerikane mbi varfërinë (U.S. Federal Poverty Guidelines) si bazë për të drejtën e përfitimit sipas të ardhurave.

Subjektet do t'i referohen dokumentacionit shoqëruar, të përfshirë në këtë dokument, sipas rastit  
Printimet e këtij dokumenti mund të jenë të papërditësuara ndaj duhet të konsiderohen të pakontrolluara.

Të ardhurat kualifikuese për eliminimin e të gjitha përgjegjësiave financiare (shëndetësi falas) për shumat që ndryshe do të ishin të detyrueshme për t'u paguar do të jenë 250 përqind i nivelit të varfërisë, siç përcaktohet nga FPG aktuale (shiko <https://aspe.hhs.gov/poverty-guidelines> për direktivat aktuale), sipas publikimit të përvitshëm të Departamentit të Shëndetësisë dhe Shërbimeve Humane.

Gjithashtu mund të kërkohen regjistrimet financiare lidhur me të ardhurat familjare të pacientit/kujdestarit, jo për t'ia caktuar përgjegjësinë një pale të tretë, por për të përcaktuar se si ndikojnë drejtpërdrejt te situata financiare e aplikuesit. Familja, siç përcaktohet nga Byroja e Censurit e Shteteve të Bashkuara, është një grup prej dy ose më shumë vetash me lidhje familjare, qoftë nga martesë, adoptimi, ose ndryshe, të cilët jetojnë së bashku (persona jo të afërm, si për shembull, shokët a shoqet e dhomës, nuk llogariten); të gjithë personat që jetojnë në të njëjtën shtëpi ose familje konsiderohen pjesëtarë të një familjeje. Corwell Health nuk konsideron personat që jetojnë në një shtëpi të vetme por veçmas si një familje e kombinuar. Gjithashtu nuk zbatohen rastet e jetesës së përkohshme si pasojë e një problemi shëndetësor.

Historia klinike, sjella dhe/ose historia sociale e pacientit nuk do të merret në konsideratë në vlerësimin e aftësisë për të paguar.

#### 6.7. Uniformiteti

Për të garantuar aplikim të njëtrajtshëm të kësaj rregulloreje brenda Corwell Health, sa më poshtë zbatohet për të gjitha qendrat e Corwell Health:

- Të gjitha faturimet do të regjistrohen në llogarinë e pacientit në përputhje me procedurat normale të faturimit. Edhe pse faturimet janë baza për regjistrimin e faturimit dhe marrjes së pagesave, kostot (jo faturimet) do të jenë njësisia kryesore e raportimit për vlerësimin e asistencës financiare.
- Shërbimeve nuk do t'u bëhet "downcoding" në një tarifë më të ulët.
- Nuk do të përdoret "mirësjellje profesionale".
- Corwell Health nuk do të bëjë dallime mbi bazën e racës, ngjyrës, origjinës kombëtare, shtetësisë, gjinisë, fesë, moshës, aftësisë të kufizuara, bindjeve politike, orientimit seksual dhe gjendjes martesore ose familjare.
- Pacientët që plotësojnë kriteret e kësaj rregulloreje dhe që miratohen për asistencë financiare do të pranohen për kujdes shëndetësor falas emergjent ose të nevojshëm gjatë periudhës së miratimit që tregohet te Seksioni 6.9. Për shkak se Corwell Health nuk u faturon asnjë shumë pacientëve që pranohen për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje, Corwell Health u përmbahet plotësisht "shumave të faturuara përgjithësisht" dhe kufizimeve "më pak se pagesa bruto" që zbatohen për spitalet e bimirësisë.

#### 6.8. Procesi i miratimit të kërkesës

**6.8.1.** Të gjitha vendimet për asistencë financiare duhet të miratohen nga personeli përkatës, siç përcaktohet në proceset dhe edukimin e pranueshmërisë për asistencë financiare.

**6.8.2.** Dokumentacioni mbështetës duhet të shoqërojë të gjitha vendimet për asistencë financiare dhe duhet të ruhet siç përcaktohet në Seksionin 6.2.7 më sipër.

#### 6.9. Periudha e miratimit

Miratimi i të gjitha kërkesave për asistencë financiare, të paraqitura sipas rregullores së të drejtës për përfitim të asistencës financiare, mund të jenë efektive për një periudhë prej të paktën 90 ditësh dhe të përfshijnë kujdes mjekësor emergjent ose të nevojshëm.

Ndryshimet në situatën financiare ose shtimi i një paguesi të palës së tretë mund të modifikojë periudhën e miratimit dhe të kërkojë shqyrtim të mëtejshëm.

#### 6.10. Procesi i ankimimit

Personat të cilëve u refuzohet asistencë financiare sipas dispozitave të rregullores mund të kërkojnë një rishikim të vendimit. Rishikimet do të bëhen në nivelin tjetër të autoritetit për miratim.



Apelimet që avancojnë mbi nivelin e administratës brenda Aksesit të Pacientit çohen në një panel të administratës së lartë të Corwell Health të zgjedhur nga SVP i Ciklit të të Ardhurave të Corwell Health ose nga personi i caktuar prej tij/saj.

#### 6.11. Përpyjekjet për marrje të pagesës në rast mospagese

Në rast se një pacient/garantues nuk aplikon apo nuk kualifikohet për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje, masat që mund të marrë Corwell Health për marrje të pagesave në rast mospagese tregohen më me hollësi në rregulloret e renditura më poshtë:

- [Rregullorja për faturimin dhe marrjen e pagesave](#) (Legacy Beaumont Health)
- [Rregullorja për faturimin dhe marrjen e pagesave nga pacientët e përgjegjshëm](#) (Legacy Spectrum Health).

Një kopje falas e rregulloreve të mësipërme mund të merret si vijon:

- Për Legacy Beaumont Health:
  - <https://www.beaumont.org/patients-families/billing/financial-assistance>
  - duke telefonuar (248) 577-9205
  - ose duke dërguar email në [patient\\_financial\\_resources@beaumont.org](mailto:patient_financial_resources@beaumont.org)
- Për Legacy Spectrum Health Lakeland:
  - <https://www.spectrumhealthlakeland.org/patient-visitor-guide/patient/billing/financial-assistance>
  - duke telefonuar (844) 408.4103
  - ose duke dërguar email në [SHLfinancialcounseling@spectrumhealth.org](mailto:SHLfinancialcounseling@spectrumhealth.org)
- Për Legacy Spectrum Health West Michigan:
  - <https://www.spectrumhealth.org/affording-care/financial-assistance>
  - duke telefonuar (800) 968.0145
  - ose duke dërguar email në [FinancialCounseling@spectrumhealth.org](mailto:FinancialCounseling@spectrumhealth.org)

Çdo personi do t'i jepet një njoftim i veçantë me shkrim të paktën 30 ditë para se të ndërmerren masa për marrje të pagesave.

#### 6.12. Baza për llogaritjen e shumave të faturuara përgjithësisht (Amounts Generally Billed, AGB)

Corwell Health (duke përfshirë subjektet përkatëse) nuk u ngarkon pacientëve që pranohen sipas Rregullores për Asistencë Financiare ("Financial Assistance Policy, FAP") më tepër për kujdes shëndetësor emergjent dhe të nevojshëm sesa shumat e faturuara përgjithësisht (AGB) atyre që kanë siguracion që ua mbulojnë këtë kujdes shëndetësor. Në vend të kësaj, Corwell Health ofron kujdes shëndetësor emergjent ose kujdes shëndetësor tjetër të nevojshëm falas për çdo pacient që plotëson kriteret e pranueshmërisë për asistencë financiare sipas kësaj rregulloreje. Corwell Health përdor metodën e shikimit pas dhe llogarit një përqindje AGB për çdo qendër spitalore duke pjesëtuar shumën e të gjitha shumave të kërkesave të tij për kujdes shëndetësor emergjent dhe të nevojshëm që është lejuar nga "tarifa-për-shërbim" e Medicare në kombinim me siguracion privat për dymbëdhjetë (12) muaj kalendarikë pararendës, me shumën e pagesave bruto përkatëse për ato kërkesa. Corwell Health poston një kopje aktuale të përshkrimit të llogaritjes dhe përqindjeve AGB në faqen tij të internetit:

- [billing-percentages-english.pdf \(beaumont.org\)](#) (Legacy Beaumont Health) .
